

VENDIM
Nr. 72/2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 70/2021, “PËR CAKTIMIN
E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE
TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe të neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikat V, VII dhe VIII, të vendimit nr. 70/2021, “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Deputeti Frrok Gjini caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe në Komisionin për Sigurinë Kombëtare.

Deputeti Petro Koçi caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 25.7.2024.